



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	27.07.2023
Nga:	ZPP GJIZIM HAJDINI
PER:	"Valdrini&NNP "Ndertimi"
Lenda :	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik ne Kosovë,përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kërkesave për Rishqyrtim per Vendim te Autoritetit Kontraktues , Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë :

VENDIM

1.Refuzohet si e pabazuar kërkesat e operatorive ekonomik "Valdrini&NNP "Ndertimi" kunder njoftimit per dhenje per projektin "Ndertimi , zgjerimi dhe rikonstruimi i rrjetit te kanalizimit ne Drenas - Projekt dy vjeqar" me nr 611-23-5133-5-1-1 si e pabazuar

OE ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim te AK me datën 24.07.2023 kunder njoftimit per dhenje dhe refuzohet si e pabazuar.

Argumentet e refuzimit te kërkeses per ri-shqyrtim jane si me poshte :

Sa i perketë pretendimeve tuaja se ju jeni eliminuar padrejtësisht nga kjo procedurë atëhere ju njoftojmë së pas analizimit te dosjës kontatimet ne lidhje me pretenimet tuaja janë si më poshtë :

1.Pretendimi i parë në lidhje me pervojën e punës së inxhinerës së mjedisti është plotësisht i pabazuar dhe arsya e eliminimit është e qendrueshme per arsye se Rregullorja e specifikonë qartë se nese CV e prezentuar nuk plotëson kërkesat – refuzo tenderit pa kerkuar sqarime . Ju në kërkesën për ri-shqyrtim si deshmi keni prezentuar një CV të re (e modifikuar) e cila nuk ka qenë e bashkangjitur me herët në dosjen e tenderit dhe si e tillë si dokument nuk mund të merret për bazë sepse ju keni mundur të njejtën ta ngarkoni në dosjen e tenderit . Nga CV e bashkangjitur në dosjen e tenderit të ofertuar nga ana e juaj nuk është plotësuar kërkesa prej 5 vite pervojë pune pas diplomimit master dhe nuk janë bashkangjitue as deshmitë .

2.Edhe arsya e dytë është e paqendrueshme për arsye se gjatë afatit për sqarime ju nuk keni drejtuar asnjë kërkesë në Ak në lidhje më këtë projektë për aprovimin e kërkesës së a mund të ofrohet certifikimi edhe nga një kopani e licencuar nga ministria . Sqarimet për projekte tjera nuk janë valide për këtë projekt dhe si të tilla nuk kanë validitet për këtë projekt .

3.Ndersa sa i perketë pasijeve të gjitha arsyet në B-42 janë të qendrueshme dhe nuk janë argumentuara të

kunderta as me provat e bashkangjitura . Sqarimet në lidhje me pasijet nuk i plotësojnë kërkesat në lidhje me pasijet .

4.Edhe në kërkesën për ri-shqyrtim ju nuk keni ofruar informata rreth kapacitetit të Cekanit pneumatikë së a e permbushë kërkesën në dosjen e tenderit qe të jetë 13 bar por keni ofruar deshmi të pasijeve tjera të cilat nuk janë konformë kërkesave të AK .

Pretendimet në lidhje me operatorin e rekomanduar për kontratë janë të pabazuara dhe janë të argumentuara si më poshtë . :

1. Sa i perketë pretenimit të parë është komplet i pabazuar për arsye së nuk janë kerkuar referenca të natyrës së njejtë por të ngjajëshme (ndertime të ulta) andaj pretendimi juaj është i pabazuar .
2. Sa i perketë pretendimit për ISO po ashtu është i pabazuar sepse kur një antarë i konzersiumit e plotëson kërkesën atherë kërkesa e AK në dosjen e tenderit është permbushur .
3. Pretendimi 3 është i pabazuar sepse kërkesa është permbushur sepse inxhinieri në fjalë është gjeodet i diplomuar dhe i licencuar dhe drejtimi mastër ka të bejë me gjeodezi dhe pervoja e punës e percakton së ka punë gjeodezike .
4. Pretendimi 4 është i papabzuar sepse në DUD specifikohet qartë se kërkesa është permbushur sepse pershkrimi i DUD është konformë kërkesës së AK .
5. Poashtu edhe pretendimi i 5 është i pabazuar sepse kamionat me numër ta tabelave 01-526-KQ dhe kamioni me numër 01-836-Jo kanë max e kapacitetit siq janë kerkuar në dosjen e tenderit dhe rrjedhimishtë plotësojnë kërkesat e DT .

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese ne Oshp ne afate prej 10 dite .